

LURA TURHANI (KOBURJA)

PRIRJE TË TERMFORMIMIT PËRMES KOMPOZIMIT

Mënyrat e formimit të termave në terminologjinë tekniko-shkencore dhe në atë të teksteve mësimore të APU-së janë:

1. mënyra semantike apo terminologjizimi
2. mënyra morfologjike me nënndarjet e saj:
 - a) prejardhja
 - b) përbërja
3. mënyra sintaksore apo togfjalësimi
4. huazimi

Përbërja (kompozimi) është një nga mënyrat e pasurimit të terminologjisë. Pas ndajshesimit, kompozimi (përbërja) është mënyra më prodhimtare e formimit të fjalëve në shqipen e sotme. Kompozitat, duke pasur të paktën dy tema motivuese, kanë zakonisht një ngarkesë semantike më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin më qartë e në mënyrë më të drejtpërdrejtë konceptin që shprehin, prandaj ato po marrin përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe, njëkohësisht, sa më ekonomike e koncepteve (ASHSH, 2002:70). Raporti midis kuptimeve të gjymtyrës dhe kuptimit të ri të gjeneruar varet nga lidhja sintaksore midis këtyre gjymtyrëve, që mund të jenë bashkërenditëse ose nënrenditëse. Sipas këtij kriteri kompozitat klasifikohen në kompozita këpujore dhe përcaktore.

Kompozitat këpujore në terminologjinë tekniko-shkencore të teksteve mësimore nuk janë të shumta në numër. Më së shumti dalin në terminologjinë e gjeografisë. Ato janë emra e më shumë mbiemra:

Emra: *verilindje*, *veriperëndim*, *juglindje*, *jugperëndim* (Gjeo. 6); *marrëdhënie* (GJ. 7); *oksido-reduktim* (K. 11).

Termi *marrëdhënie* është kompozitë që nuk është formuar brenda fushës së gjuhësisë, por që, e përdorur brenda fushës, zbërthehet me elemente formale si kompozitat e tjera të fushës. Ky term del në përbërje të togfjalëshave terminologjike: *marrëdhënie bashkërenditëse*, *marrëdhënie nënrenditëse*, *marrëdhënie të barazisë*.

Mbiemra: *nxitëse-thirrmore* (Gj. 5); *fiziko-gjeografik*, *bujqësor-industrial*, (Gjeo. 6), *verilindor* (Gjeo. 8); *oksido-reduktimi* (K. 9); *molekularo-kinetike* (Sh. N. 12).

Të përafërta në mënyrën e ndërtimit me kompozitat e mësipërme janë kompozitat me lidhje bashkërenditëse të gjymtyrëve përbërëse, si: *ligji i Gej-*

Lysakut (F. 9), *ligji i Faradei-Neman* (F. 11), *eksperimenti i Majkelson-Morit* (F. 12).

Kompozitat përcaktore në terminologjinë e teksteve mësimore janë më të shumta. Termat-kompozitë dallohen për motivueshmëri dhe tejdukshmëri falë lidhjes semantike mes gjymtyrëve përbërëse. Veçori kryesore e kompozitave të tilla është aftësia që ato kanë për t'u formuar edhe pa pasur si bazë ndonjë togfjalësh të caktuar, mjafton që materiali gjuhësor si edhe koncepti që do të shënohet prej tij, të sintetizohen brenda modelit gjuhësor ekzistues. (Duro, A. 1986:641) Ato dalin vetëm si terma-emra e terma-mbiemra.

Terma të përbërë emra

1. Emër + emër

a. Gjymtyra e dytë është një emër foljor i vepruesit me prapashtesën -(ë)s. Formimet e këtij tipi emërtojnë koncepte, procese a sende me vlerë vepruesish. Këto kompozita në terminologjinë e vjelë marrin karakteristikat e mbiemrit dhe përdoren si gjymtyrë përcaktuese në togfjalëshat terminologjikë.

fjalëformues, trajtëformues (Gj. 6); *barngrënës, kufomëngrënës, gjetherënës* (D. N. 4), *dëmtuesvrasës* (B. 6), *qelizadjegës* (B. 8), *forcëmatës*, (F. 7), *qendërsynues* (F. 10); *klimëformues, malformues, shiprurës* (Gjeo. 6), *kodrinëmbajtës*, (Gjeo12); *kripëformues* (K. 8).

Ky tip kompozite përfshin terma të përbërë, si: *llumrangrënës, lëngjepirës, pezullngrënës*, të cilët janë formuar në mënyrë analogjike sipas gjedhit *këpucëbërës = ai që bën këpucë*.

Vërehet se tek disa kompozita të këtij lloji elementi i dytë, ai i përcaktuar, merr pjesë në kompozimin e termave të fushave të ndryshme. Kështu p.sh., tema e dytë *formues*, emër prejfoljor vepruesi, është fjalë me kuptim të përgjithshëm, i jep semantikisht marrëdhënies sintaktike vlerën e vepruesit. Ajo lidhet me gjymtyrët përcaktuese, që janë terma të mirëfilltë në fushat e dijes: gjuhësi / fjalëformim, biologji / botanikë, zoologji, gjeografi/gjeologji, kimi. Në të tilla kompozita, është gjymtyra përcaktuese, nëngjymtyra (Dervishi, V. 1991/1:73) elementi që identifikon dhe diferencon termin e formuar. Duke qenë terma të mirëfilltë në fushat përkatëse të dijes, ata modifikojnë termin e ri, duke përcaktuar vendin e njësisë emërtuese në sistemin terminologjik.

b. Gjymtyra e dytë është një emër foljor i veprimi me prapashtesat *-im* dhe *-je* si dhe një emër çfarëdo. Edhe pse pranohet se kompozita të tilla kanë përgjithësisht kuptim abstrakt (ASHSH 1976:246), në terminologjinë e gjeografisë termat e këtij tipi kanë kuptim konkret:

fjalëformim vendndodhje (M. 5), *frymënxjerrje, frymëkëmbim* (D.N.4), *llojformim* (B. 8), *ozmorregullim*, (B. 12); *vendndbanim, kryeqendër, grykëderdhje, vendndodhje* (Gjeo. 6);

Ndajfolje + emër

gjysmëndihmëse (Gj. 5); *sipërfaqe* (M. 6); *barabrinjës* (M. 8); *kundërtrupa* (B.8); *baraspeshë* (F. 6), *gjysmëpërcjellës*, *gjysmëzbërthim* (F. 11).

Në klasifikimin e mësipërm sipas gjymtyrëve të kompozitës, kemi ndarë në dy grupe fjalët e përbëra ku njëra nga temat është fjala *gjysmë*. Kemi gjykuar që në termat *gjysmëdrejtëz* dhe *gjysmëhënë*, elementi bashkëformues *gjysmë* del me semantikën e një emri dhe kompozitat marrin kuptim konkret: *gjysmëdrejtëz* “pjesë e drejtëzës me kufi vetëm nga njëra anë” (FGJSH 2006); *gjysmëhënë*: hënë së cilës i duket gjysma, gjysma e hënës, “hënë e ndriçuar përgjysmë” (FGJSH 2006). Ndërsa në termat *gjysmëndihmës(e)*, *gjysmëpërcjellës* dhe *gjysmëzbërthim*, fjala-temë *gjysmë* ka vlerë semantike ndajfoljore (jo plotësisht, jo i tërë); termi *gjysmëndihmës* në togfjalëshin *folje gjysmëndihmëse* nuk do të thotë që ndihmon përgjysmë, por ka kuptimin: “që luan rol ndihmës, pa humbur plotësisht kuptimin leksikor dhe mëvetësinë”; *gjysmëpërcjellës* nuk do të thotë: gjysma e përcjellësit, por: “lëndë me përçueshmëri elektrike të dobët” (FGJSH 2006). “Kuptimi i fjalës së përbërë mund të jetë, por edhe mund të mos jetë i barabartë me shumën e kuptimeve të pjesëve të saj përbërëse.” (Kostallari, A. 1972:85)

Numëror (ose shumë) + emër në rrjedhore të pashquar shumë

njërrokësh, *shumërokësh* (GJ. 2), *dygjuhësh* (Gj. 6) *shumëpikësh*, *trekëndësh*, (M. 4), *dyfaqësh* (M. 8); *shumëgjenesh* (Bio. 10);

“Pavarësisht nga numri i temave që hyjnë në përbërje, kompozitat e shqipes janë kurdoherë formime dygjymtyrëshe...” (Kostallari, A. 1972:85) Ndër termat e vjelë, vërehet se kompozitat janë përgjithësisht formime prej dy temash. Në terminologjinë e gjuhësisë dalin edhe kompozita ku janë bashkuar tri tema: *njëkryegjymtyrëshe* dhe *dykryegjymtyrëshe*.

Përemër + emër

vetushqyes, *jetërushqyes* (D. N. 4), *vetëpastrim* (B. 11), *gjithçkangrënës* (D. N. 4).

Numëror (a përemri shumë) + emër + një prapashtesë

njëkohësi, *njëkuptimësi*, *shumëkuptimësi* (GJ.), *shumëllojshmëri* (B. 6) etj.

Terma-mbiemra të formuar me kompozim

Emër + mbiemër

kuptimplotë (Gj. 8), *kënddrejtë* (M. 8); *vijëdrejtë* (F. 7) *farëveshur*, *farëzhveshur* (D. N. 3) etj.

Numëror (ose përemër) + mbiemër

Si gjymtyrë e parë në këtë tip formimi mund të shërbejë çdo numëror, ndërsa nga përemrat marrin pjesë ata që tregojnë sasi të papërcaktuar:

i dygjinishëm, *i shumëkuptimshëm* (GJ. 8), *njëvetor* (GJ. 9); *trekëndor*, (M. 4), *i njëvlershëm* (M. 5), *i njëtrajtshëm* (D. N. 3), *njëthelbor*, (D.N.4),

njëqelizor, shumëqelizor (D.N. 5), *dymbëdhjetëgishtor(e)* (B. 6) *dyanësor* (B. 7); *dyatomik(e), tridimensional* (K. 11),

Të tilla formime kanë përhapje të gjerë në fushën e shkencës dhe të teknikës, për shkak se te to, koncepti shprehet në mënyrë mjaft të tejdukshme. Gjithashtu, ato dëshmojnë për prirjen e mjeteve shprehëse drejt njëfjalësimit në terminologji.

BIBLIOGRAFI

- Kostallari, A. (1972), *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I”, Tiranë, f. 85.
- Picht, H. (1985), *Terminology: An Introduction*, Kopenhagen, f. 61.
- ASHSH (2002), Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, f. 70.
- Duro, A. (1986), *Fjalët e përbëra në terminologjinë tekniko-shkencore*, në “Studime për nder të A. Xhuvanit”, Tiranë, f. 639.
- Cipo, K. (1972), *Rreth disa kompozitave*, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I. Tiranë, f. 64.
- Dervishi, V. (1991), *Termet e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor*, Studime Filologjike, 1, f. 73.
- Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976), *Elemente të normës së sotme letrare kombëtare*, Tiranë, f. 246.
- Hysa, E. (2002/1-2), *Vëzhgime rreth formimit të emrit me ndajshesa*, Tiranë, f. 34.